



**SHERBIMI SOCIAL**

## #TETORI I DEDIKOHET LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT



Në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit kundër Trafikimit, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social kanë zhvilluar gjatë të gjithë muajit Tetor fushatat e ndërgjegjësimit dhe informimit për të luftuar fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Duke besuar se përmes informimit mund të ç'rrenjosim trafikimin, QKTVT dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, kanë zhvilluar takime dhe kanë shpërndarë fletë-palosje në të gjitha shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në Shqipëri!

## #1 TETORI- DITA NDËRKOMBËTARE E MOSHËS SË TRETË



E nisëm muajin Tetor në Shtëpinë e Gjyshërve të Shërbimit Social Shtetëror në Tiranë. 1 Tetori është Dita Ndërkombëtare e Moshës së Tretë, një ditë në të cilën gjithnjë e më tepër duhet të promovojmë një shoqëri miqësore për të gjitha moshat.

Aktivitetin tonë me të moshuarit e mbështetën edhe disa vogëlushë të cilët realizuan një program artistik për ta bërë ditën e gjyshërve më të bukur.



**SHERBIMI SOCIAL**

## #DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Gjatë muajit Tetor 2019 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka përfunduar draft raportin mbi kontrollin e realizuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër.

Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin Tetor. Gjithashtu është monitoruar sistemi për hedhjen e familjeve ekstremisht të varfra në 12 qarqet e vendit.

Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark, si edhe është monitoruar procesi i mbledhjes së Këshillave Bashkiakë për marrjen e vendimeve.



## #DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Tetor 2019, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka trajtuar 3 raste VT/VMT.

Është mbledhur Komisioni për Fëmijët, si rezultat janë pranuar 3 fëmijë në IPSH dhe janë transferuar 2 fëmijë në IPSH të tjera.

Është mbledhur Komisioni për të Moshuarit, ku janë shqyrtuar 12 raste, janë sistemuar në IPSH 6 prej tyre, ndërsa 4 të moshuar janë transferuar.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku janë shqyrtuar 100 raste, nga të cilat 44 raste janë paisur për herë të parë me Librezën e Statusit të Jetimit, ndërsa në 51 raste është bërë rinovimi i librezës.

Sipas planit të miratuar të Drejtorisë është bërë monitorimi i Shtëpisë së Fëmijës Durrës, Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës dhe Shtëpisë së të Moshuarve Kavajë, për të cilat janë lënë rekomandime për t'u plotësuar.





SHERBIMI SOCIAL

## #INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Denisi ishte një nga përfituesit e shërbimeve sociale pranë “Shtëpi-Familjes për të Rinjtë 16-18 vjeç Shkodër”. Në prag të 18 vjetorit të tij, kur sipas ligjit përfundon afati i qëndrimit në institucion, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër mori masa që të riut t'i krijoheshin kushtet e përshtatshme për një jetesë normale.

Në sajë të ndërmjetësisimit me shoqërinë "AbaniaTours Resort" u arrit punësimi dhe strehimi i Denisit, i cili tashmë ka një jetesë të pavarur pas daljes nga institucioni.

Punë të mbarë Denis!

Gjysh Andrian mbase e keni parë rrugëve të qytetit pasi jetonte i braktisur nga të afërmit e tij. Tashmë ai ka një shtëpi të re, të madhe dhe shumë mikpritëse.

Shërbimi Social Shtetëror, pas njohjes me rastin nga mediat, bëri të mundur sistemimin e menjëhershëm të të moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, ku nuk do t'i mungojë kujdesi dhe dashuria!





**SHERBIMI SOCIAL**

## #DE-INSTTUCIONALIZIMI



Plani i De-Institucionalizimit ka marrë prej kohësh rrugën e zbatimit të tij në shumë prej institucioneve tona të përkujdesit shoqëror. Këtë herë ju prezantojmë me Klajdin, i cili gjatë muajit Tetor u kthye në familjen e tij biologjike.

Klajdi ka marrë shërbime sociale në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës për një periudhë 9 vjeçare dhe tani më falë përpjekjeve tona u kthye me sukses pranë gjirit të familjes.

Urime Klajdi, jetë të lumtur pranë familjes!

## #NDËRMJETËSIMI PËR PUNËSIM NË TË GJITHA DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Shërbimi Social Shtetëror beson se zgjidhja më e qëndrueshme për një familje është punësimi. Në kuadër të këtij misioni, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror po zhvillojnë takime bashkëpunimi me Zyrat e Punës në secilin Qark për të vendosur urat e bashkëpunimit për punësimin e anëtarëve madhore të familjeve që përfitojnë nga skema e Ndhmës Ekonomike.

